# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-471546**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | ISP zbulon sukseset dhe kritikat ndaj ambasadorët amerikanë të Shqipërisë që janë emëruar gjatë 35 vit eve (LISTA) |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/aktualitet/emerimi-i-eric-wendt-isp-zbulon-sukseset-dhe-kritikat-ndaj-ambasadore-i402089` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 13:25:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 13:21:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 8199b506dc87e990ba23b18170d55e975d6326f07555394e868cd4542db686be |
| TEKSTI | 59305fa4216c5021eb5fbc635d7dfa1a091a4f68c4dc34147ededd3a77d000e5 |
| PAMJA | a867b00f8959b997b26ee725cd858ad9a24c3bd36f935d657ec2fb562abfe266 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | c37be3f4e8e858baa0fc5727849d80d96cac759d2ac7bd304b40be68d8a565ad |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 37fa8ea76a78e5b04e7fbef6a77a32a9f5044a1541a67ae3d0621621d26aebcc |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c37be3f4e8e858baa0fc5727849d80d96cac759d2ac7bd304b40be68d8a565ad`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Aktualitet

26 Shtator 2026, 15:21

# ISP zbulon sukseset dhe kritikat ndaj ambasadorët amerikanë të Shqipërisë që janë emëruar gjatë 35 viteve (LISTA)

Shkruar nga **Newsbomb**




**Ambasadori i ri amerikan në Shqipëri, Eric Wendt**

Gjenerali veteran Eric Wendt është emëruar si ambasador i ri amerikan në Shqipëri. Prej vitit 2023 SHBA nuk kanë ambasador funksional në Tiranë, dy të ngarkuar me punë kanë ushtruar funksionet përfaqësuese. Emërimi i ambasadorit të ri është lajm i mirë për Shqipërinë në kushtet kur SHBA mbetet vendi kryesor në qasjen e aleancës strategjike dhe kur Shqipëria është një prej dy vendeve më pro amerikane në Europë.

Tabela e hartuar nga ekspertët e ISP ofron të dhëna për ambasadorët e emëruar, dorëhequr apo të deleguar në Shqipëri nga marsi i vitit 1991 kur u rivendosën marrëdhëniet diplomatike. Vendosja e ambasadës amerikane më 1991 mbetet një ngjarje historike për Shqipërinë. Prezenca aktive amerikane ka qenë e mbetet një garanci për stabilitetin e brendshëm dhe orientimin perëndimor të Shqipërisë.

Në tërësi ambasadorët amerikanë kanë qenë figura me rol thelbësor e ndikim të madh në jetën politike në Shqipëri. Ata kanë qenë e mbeten figurat më të referuara nga media, nga partitë politike dhe nga grupet kritike qytetare, si dhe njerëz me ndikim të madh në ngjarjet më të rëndësishme politike post 1991.

Mbështetja ose kritika amerikane ka qenë përcaktuese për suksesin ose dështimin e qeverive shqiptare, karrierës së liderëve më të rëndësishëm politikë dhe rotacionet politike në Shqipëri, edhe pse zyrtarisht pala amerikane, përfshirë ambasadorët, nuk janë votues dhe nuk pranojnë ndikim direkt në zgjedhje ose karrierën politike. Zyrtarisht

Revista




Abonohu tani dhe lexoje

## Lajmet e fundit


Sporti
Nga porta në sulm, Rolando Maran i beson eksperiencës dhe super-formës (FORMACIONI I MUNDSHËM)


Kulture & Art
"Mora Fjalë" drejt zhdukjes nga interneti, autori kërkon ndalimin e këngës

Zbulo më shumë artikuj

ndikimi i tyre është shprehur përmes deklaratave publike, raporteve zyrtare, vizitave të zyrtarëve të lartë amerikanë, lobimit pro ose kritik me qeveri e liderë politikë të caktuar, etj.

Nëse do të bënin një ndarje midis preferencave politike shumica e ambasadorëve kanë pasur e kanë mbështetje e simpati nga njëra palë politike (e majtë), pjesa tjetër nga pala rivale politike (e djathtë) dhe vetëm emra të veçantë kanë pasur e kanë mbështetje e simpati nga dy palët politike. Sipas traditës tonë politike simpatia nuk barazohet me meritat, por me përputhjen e qëndrimeve ndaj interesave të mazhorancave apo opozitave të caktuara politike gjatë mandatit të tij. Ndaj edhe ky vlerësim është subjektiv dhe rrallë ndodh të ketë përputhje me vlerësimin e memories kolektive qytetare e shtetërore.

Tabela ilustrative e hartuar nga Instituti i Studimeve Politike (ISP) mbi mandatet diplomatike të ambasadorëve amerikanë, afati kohor, karriera, ecuria më pas e saj, është shoqëruar për herë të parë edhe me tre elementë të tjerë: arritja më e madhe e Shqipërisë gjatë mandatit të tyre, problematika/kritika kryesore gjatë mandatit, karriera para dhe pas funksionit në Shqipëri.

**HISTORIA E AMBASADORËVE AMERIKANË NË SHQIPËRI 1991–2026: KARRIERA, SUKSESI DHE KRITIKAT**

ISP
Instituti i Studimeve Politike

| | Emri dhe Mbiemri | Pozicioni | Nisi misionin | U largua | Pas misionit në Tiranë | Fokusi kryesor i detyrës në Shqipëri | Arritjet e Shqipërisë | Kritikat kryesore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Eric Wendt | Ambasador | Maj 2026 | – | – | – | – | – |
| 2. | Nancy VanHorn | Chargé d'Affaires | Gusht 2024 | Qershor 2026 | – | SPAK, antikorrupsioni, siguria | Hetime VIP dhe hapja e Cluster One | Ndryshimi i qasjes nga DASH |
| 3. | David J. Kostelancik | Ambasador | Nominuar 2024, nuk kaloi në Senat | – | Ekspert për WB në CEPA | Fokus, siguria kibernetike / reforma në drejtësi | – | – |
| 4. | David Wisner | Chargé d'Affaires | Gusht 2023 | Gusht 2024 | Chargé d'Affaires, Pragë | Reforma në drejtësi, hetimi i zyrtarëve të lartë | Baza e NATO-s / forcimi i SPAK | Nuk la gjurmë në memorien publike |
| 5. | Yuri Kim | Ambasador | Janar 2020 | Qershor 2023 | Zyrtare drejtuese, DASH | Funksionaliteti i SPAK dhe BKH | Çelja e negociatave me BE, ngritja e SPAK | Opozita sulme kritike (non grata SB) |
| 6. | Kathleen Ann Kavalec | Ambasador | Nominuar 2019, dorëheqje në Senat | – | Ambasador në Rumani | Nuk pati platformë zyrtare | – | – |
| 7. | Leyla Moses-Ones | Chargé d'Affaires | Shtator 2018 | Janar 2020 | Zv/ambasadore Belize | Kriza e mandateve (PD) dhe bojkoti të zgjedhjeve | Rekomandimi pa kushte për negociata | Nuk parandaloi dot krizën politike |
| 8. | Donald Lu | Ambasador | Janar 2015 | Korrik 2018 | Ambasador në Kirgistan | Reforma në drejtësi dhe dekriminalizimi | Miratimi i Reformës në Drejtësi | Tolerimi i kanabizimit, imponimi i reformës |
| 9. | Alexander A. Arvizu | Ambasador | Tetor 2010 | Janar 2015 | Zyrtar drejtues, DASH | Kriza pas ngjarjeve të 21 janarit 2011 | Liberalizimi i vizave / progresi me BE | 21 janari dhe qeveritë si prioritet |
| 10. | John L. Withers II | Ambasador | Gusht 2007 | Gusht 2010 | Doli në pension | Hyrja në NATO dhe kriza zgjedhore 2009 | Hyrja në NATO | Kriza 2009 dhe ndryshimet kushtetuese |
| 11. | Marcie B. Ries | Ambasador | Tetor 2004 | Qershor 2007 | Ambasador në Bullgari | Vizita e Presidentit Bush | Rotacion politik, progresi MSA | Ulje e profilit të angazhimit amerikan |
| 12. | James F. Jeffrey | Ambasador | Tetor 2002 | Maj 2004 | Ambasador në Irak | Antikorrupsioni dhe antiterrorist post-9/11 | Adriatik 3 dhe stabiliteti demokratik | Protesta dhe korrupsioni i lartë |
| 13. | Joseph Limprecht | Ambasador | Shtator 1999 | Maj 2002 | Ndërroi jetë në Shqipëri | Siguria dhe ngritja e antikorrupsionit | Rikthimi i normalitetit shtetëror | Atashimi i fortë me qeverinë |
| 14. | Marisa R. Lino | Ambasador | Shtator 1996 | Maj 1999 | Zyrtare në DASH/DHS | Kriza post-1997 dhe lufta në Kosovë | Kushtetuta 1998 dhe Kosova 1999 | Kriza 1997 dhe qasja pro qeverive |
| 15. | Joseph E. Lake | Ambasador | Tetor 1994 | Mars 1996 | Vijoi karrierë diplomatike | Mbështetja për institucionet & tregun e lirë | Hyrja në KE / progresi me PfP | Ligjet penalizuese për zgjedhjet |
| 16. | William E. Ryerson | Ambasador | Dhjetor 1991 | Tetor 1994 | Zyrtar në DASH | Hapja e ambasadës dhe ndryshimi politik | Rotacioni politik, nisja e demokratizimit | Atashimi pranë PD / arrestimi i Nanos |
| 17. | Cristofer R. Hill | Chargé d'Affaires | Tetor 1991 | Dhjetor 1991 | Ambasador Kosovë / Serbi | Vizita e J. Baker / rivendosja e marrëdhënieve | Hapja e ambasadës amerikane | Qasja pragmatike ndaj elitave të vjetra |

Autor: Instituti i Studimeve Politike (ISP), 2026

---

Të dhënat janë të larmishme dhe treguese se shteti ynë ka shfaqur raporte preferenciale në varësi nga raportet midis Presidentit apo mazhorancave qeverisëse ndaj ambasadorit në detyrë, siç edhe një pjesë e atyre që konsiderohen kritika nuk duhen lexuar si përgjegjësi e palës amerikane, por kryesisht janë përgjegjësi e faturë e palës shqiptare gjatë fazës përkatëse të mandatit amerikan.

Ka një tezë politike për vendet e vogla në tranzicion: sa më të fortë e ndikues të jenë ambasadorët në një vend sovran, aq më të dobëta mbeten institucionet vendore dhe aftësia e vendit për të krijuar sistem funksional qeverisëse në plan afatshkurtër. Roli i ndërkombëtarëve në vende të vogla është sa pozitiv aq edhe i kalkuluar me interesat e vetë aktorëve ndërkombëtarë, interesa që shpeshherë në vend të modelit demokratik si burim stabiliteti afatgjatë preferojnë edhe modelin e stabilitetit afatshkurtër në kurriz të demokracisë.

Ndryshe nga tradita, në Shqipëri gjithashtu gjerësisht me të drejtë besohet se roli i ndërkombëtarëve, sidomos i SHBA e BE mbetet unik, jetik dhe përcaktues për progresin shtetëror dhe integrues. Kjo edhe për shkak të teorisë së kompensimit, – kur një vend ka ambasadorë të huaj të fortë dhe ndikues kjo do të thotë se elitat e tij politike janë të dobëta, të korruptuara dhe të paqëndrueshme, – një tezë që besohet nga shumica qytetare edhe këtu, në vendin zyrtarisht më anti-amerikan gjatë 1948-1990 dhe më pro amerikan pas 1991 e në vijim. SHBA pati rol përcaktues në njohjen shqiptare 1920, në fitoren e Luftës së II Botërore, në rënien e sistemit komunist (1989-1990), në çlirimin e Kosovës 1999 dhe në futjen e Shqipërisë në NATO 2008. Ndaj çdo ambasador e diplomat amerikan që vjen në Shqipëri, gjen mikpritje të madhe, por ka edhe pritshmëri të mëdha, shpeshherë më të mëdha sesa mundësitë, kapacitetet dhe mandati i tij/saj. Për më tepër në kohën kur jetojmë, një ndryshim thelbësor i raporteve dhe elementëve të sigurisë, partneritetit dhe raporteve ndërshtetërore, forcimi i prezencës amerikane dhe raporteve me SHBA, mbetet nevojë jetike, prioritet dhe pritshmëri për Shqipërinë dhe Kosovën./ **INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE**

## Sondazh

Poll

### Lexo gjithashtu

Aktualitet



E Shtunë 15:02 Newsbomb

# Po rregullonte pompën e varkës dhe ra në kontakt me rrymën elektrike, 28-vjeçari VDES në duart e mjekëve të Durrësit




Aktualitet

Shijaku vlerëson kontributin e agronomit që i shërbeu brezave të tërë, emri i ENVER DUKES skalitet në një prej rrugëve të qytetit

E Shtunë 14:54




Aktualitet

"Toyota" merr përpara këmbësoren në vijat e bardha, niset me urgjencë në spital (EMRI)

E Shtunë 14:50 Newsbomb

Aktualitet




E Shtunë 14:31

# Dy Medalje të Arta te Mjekësia, studentët ekselentë, doktorët e së nesërmes vlerësohen nga Fakulteti: Jeni krenaria e

## shkollës! (EMRAT)



Aktualitet

Çfarë ndodhi dje te "Zogu i Zi"? Plumbat kapën 33-vjeçarin, i përfshirë dhe 20-vjeçari i njohur si "Leumasi": Qëlloi me thikë, u plagos dhe vetë (E PLOTË)

E Shtunë 14:07 Newsbomb



Aktualitet

Oborri i bibliotekës së Universitetit të Shkodrës në parkim me pagesë, aktivisti "sfidon" Becin: Liro vendin që shfrytëzon shefja e kabinetit tënd

E Shtunë 13:47 Newsbomb




E Shtunë 13:39

## Shpërthimi i fuqishëm rrënoi ndërtesën në zemër të Athinës, zbardhen IDENTITETET: 3 nga viktimat janë shqiptarë! Motra, vëllai dhe gruaja e tij kishin ardhur nga Amerika (FOTO)



Aktualitet

Shtetasi i huaj bie në kontakt me rrymën elektrike në Durrës, ishte në një varkë në bregdet (DETAJET e para)

E Shtunë 13:19 Newsbomb



Aktualitet

Antikontrabanda ndalon mallra të padeklaruara, shoferët duhet të paguajnë tani 2.5 milionë lekë gjobë për 1.6 milionë detyrime që tentuan të shmangnin

E Shtunë 13:11




E Shtunë 13:01 Newsbomb

**ARRESTOHET në Larushk 41-vjeçari i kërkuar nga drejtësia shqiptare, Gjykata e Tiranës e kishte dënuar për drogë**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.